



## ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 06.09.2017, mori në shqyrtim praktikatat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Në lidhje me licensimin e shoqërisë Operatori Sistemit Transmetimit “OST” sh.a., në aktivitetin e operimit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.
2. Mbi miratimin e “Rregullores së procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.
3. Në lidhje me fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullores mbi percaktimin e miratimin e pagesave rregullatore”.
4. Në lidhje me licencimin e shoqërisë “ALIN TRADING” sh.p.k., në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
5. Në lidhje me fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Afrimi K” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Thanzë”.
6. Në lidhje me fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Hydro Power Plant of Korça” sh.p.k për vendosje të pengut mbi kuotat e kapitalit, sendet e paluajtshme si dhe hipoteken mbi sendet e paluajtshme të shoqërisë.
7. Në lidhje me licensimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
8. Në lidhje me Licensimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike.
9. Në lidhje me fillimin e procedurës për miratimin e Metodologjisë së tarifës së përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror.
10. Në lidhje me licensimin e shoqërisë “The Blue Star” sh.p.k., në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
11. Në lidhje me licensimin e shoqërisë “Energy to Energy” sh.p.k., në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.